



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ANILA Q. KAÇUPI
ADRESA NR.10, RESHIT COLLAKU,
AURORA, NR.1, NR.8
TEL: 676049924

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 5279

Nr. koleksioni: 1465

Tirane më 27/05/2022

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29 07 1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10 03 2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20.12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2022052940175068486



KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI

Sot, më datë 27.05.2022, para meje Notere ANILA O. KACUPI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.10, RESHIT COLLAKU, AURORA, NR.1, NR.8, u paraqit personalisht:

SHITES:

Shkelqim Beshiri, atësia Liman, amësia Mine, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Budi; Nd. .; Njësia Administrative Nr. 2; Njesia Bashkiake Nr. 2; 1003; Tiranë, lindur më 22/08/1966, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033394789 dhe nr. personal G60822041V.

BLERES:

Enkelejda Beshiri, atësia Servet, amësia Myzejen, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë, me adresë Budi; Nd. .; Njësia Administrative Nr. 2; Njesia Bashkiake Nr. 2; 1003; Tiranë, lindur më 15/08/1976, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 035351706 dhe nr. personal H65815060D.

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noteri konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, neni 705-746 e vijues i tij, ligji nr. 110/2018 "Për Noterinë", , bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noteri hartimin e Kontratës së Shitjes Pasuri e Luajtshme - Kuota, sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore, si më poshtë vijon:

MEQENËSE:

Kushtet paraprake

- Shitësi është ortak i vetem dhe zotëron 100 (njëqind) kuota të barabarta me 100% (njëqind për qind) të kapitalit themeltar të shoqërisë të së drejtës shqiptare "KLAR & COFFEE" sh.p.k, person juridik, regjistruar me NIPT K81309045E, me seli ne Rruga 'Pjeter Budi', Pallati Lim-Em, Kt. 2, Tirane, perfaqesuar nga Administratori Zj. Brunilta Karaj, Shqipëri (në vijim referuar edhe si "Shoqëria");
- Shitësi dëshiron t'i shesë Blerësit 100 (njëqind) kuota të barabarta me 100% (njëqind për qind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë, (në vijim referuar edhe si "Kuota"), sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në vijim;
- Blerësi dëshiron të blejë nga Shitësi 100 (njëqind) Kuotat e barabarta me 100% (njëqind për qind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë, sipas kushteve dhe afateve të mëposhtme;
- Më datë ____ .05.2022 përpara nënshkrimit të kësaj Kontrate, asambleja e përgjithshme e Shoqërisë, ka miratuar transferimin e Kuotave.

Meqë ekzistojnë kushtet paraprake, Palët, pranojnë të lidhin dhe në fakt lidhin këtë Kontratë sipas kushteve të mëposhtme:

Neni 1

Kushtet paraprake

Kushtet paraprake janë pjesë përbërëse dhe thelbësore të kësaj Kontrate.

Neni 2



Shitja e kuotës

Nëpërmjet kësaj Kontrate, Shitësi bie dakort te shese, transferoje dhe dorezoje 100 (njeqind) kuotat e barabarte me 100% (njqind përqind) te pjesemarrjes te kapitalit themeltar qe ai zoterton ne shoqerine "KLAR & COFFEE" sh.p.k., të lirë nga çdo peng, privilegj, barrë, e drejtë parablerje apo çdo të drejtë tjetër në favor të të tretëve, në favor të Blerësit, i cili, pranon dhe blen, sipas kushteve dhe afateve të parashikuara në këtë Kontratë.

Shitja dhe transferimi i titullit te kuotes behet me nenshkrimin e kesaj kontrate dhe dorezimin e kuotes tek bleresi, i cili merr persiper te gjitha te drejttat dhe detyrimet e shitesit dhe ne veçanti te drejten per te marre pjese ne fitimet e shoqerise, per te ndare pasurine e shoqerise si dhe merr persiper detyrimet dhe pasivet e mundeshme. Palet bihen dakort se pagesa e çmimit do te behet sipas percaktimeve te nenit 3 te kesaj kontrate. Nëpërmjet kësaj Kontrate, Shitësi bie dakort dhe bleresi pranon sa me siper dhe behet pronar i 100% te cdo te drejte, asetëve te inventarizuara dhe pasurie qe zoteron shoqeria "KLAR & COFFEE" sh.p.k.,

Pas nënshkrimit të kësaj Kontrate, struktura e zotërimit te kapitalit te Shoqërisë "KLAR & COFFEE" sh.p.k, do te jete:

***Enkelejda Beshiri** zoteruese e 100 te kuotave e cila konsiston ne 100% te kapitalit themeltar, me vleren te pergjithshme 100.000,00 leke.

Neni 3

Çmimi

Çmimi i shitjes i pasurise objekt i kësaj kontrate shitje do te jete ne vleren prej **100'000 (njqind mije) Leke** te cilat do te paguhen nga pala blerese ne favor te pales shitesë nepermjet bankes se nivelit te dyte.

Pavaresisht kryerjes se pageses si me lart percaktuar, kuota, objekt i kesaj kontrate do te kalojne ne favor te Bleresit, Znj Enkelejda Beshiri, atësia Servet, amësia Myzejen, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë, me adresë Budi; Nd. .; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake

Neni 4

Deklarime dhe Garanci të Shitësit

Shitësi garanton Blerësin se është personi i vetëm legjitim për të marrë përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet e kësaj Kontrate.

Shitësi garanton Blerësin se Kuota objekt i kësaj Kontrate, është e lirë nga çdo peng, privilegj, barrë, e drejtë parablerje apo çdo të drejtë tjetër në favor të të tretëve.

Blerësi deklaron se blen Kuotën e Shitësit, sipas gjendjes së faktit dhe të së drejtës në të cilën ajo ndodhet në momentin e nënshkrimit të kësaj Kontrate.

Shitesi me nenshkrimin e kesaj kontrates nuk ka dhe nuk do te kete asnje pretendim ne lidhje me 100 (kuotat) e barazvlefshme me 100% (njqind përqind) te pjesemarrjes te kapitalit themeltar te shoqerise "KLAR & COFFEE" qe ai zoteronte.

Kjo kontrate do te jete e detyrueshme dhe do te kete pasoja juridike ndaj paleve, trashegimtareve te tyre, si dhe ndaj atyre te cileve iu eshte ceduar ne menyre te rregullt.

Neni 5

Shpenzimet dhe taksat

Shpenzimet e tjera do te paguhen nga palet sipas legjislacionit ne fuqi.

NENI 6

Interpretimi i kontratës

Kushtet e përcaktuara në këtë kontratë interpretohen pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, por duke pasur parasysh qëllimin e vërtetë të palëve, që i ka shtyrë për nënshkrimin e këtij akti.



A2022052940175068486

Kushtet e kontratës interpretohen njëri nëpërmjet tjetrit, duke i dhënë secilit kuptimin që del nga tërësia e aktit. Në rast dyshimi, kontrata ose kushtet e saja interpretohen në kuptimin në të cilin mund të kenë ndonjë efekt dhe jo në atë, sipas të cilit nuk do të kishte ndonjë efekt.

Nese pjese te kesaj kontrate jane ose behen te pavlefshme ose jodetyruese, palet do te jene te detyruara te zbatojne pjesen tjeter te kontrates, Ne kete rast, palet do te zvendesojne pjesen e pavlefshme ose jo detyruese me parashikime te vlefshme e detyruese efektet e te cilave sipas permbajtjes dhe qellimeve te kesaj kontrate duhet te jene ne kufijte e te mundshmes, e ngjashme me pjesen e pavlefshme ose jodetyruese.

NENI 7

Mosmarrëveshjet

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të shfaqen, direkt ose indirekt, midis palëve kontraktuese në lidhje me interpretimin, ekzekutimin, zgjidhjen apo vlefshmërinë e kësaj kontrate palët paraprakisht duhet të diskutojnë në lidhje me këto mosmarrëveshje për zgjidhjen e tyre me mirëkuptim. Nëse nuk arrihet një marrëveshje sipas parashikimeve të bëra në këtë nen për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve kompetente është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.

Neni 8

Ligji i zbatueshëm

Kjo Kontrate rregullohet nga legjislacioni shqiptar dhe shpreh vullnetin e Paleve.

Neni 9

Përmbajtja e Kontratës dhe Ndryshimet

Kjo Kontratë përfshin tërësisht raportet ndërmjet Palëve në lidhje me transferimin e 100 (njqind) te kuotave e barazvlefshme me 100% (njqind perqind) te pjesemarrjes te kapitalit themeltar qe zoteron shitesi, tek Blerësi dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet apo deklaratimet e mëparshme në lidhje me objektin në fjalë. Ndryshime apo shfuqizime të ndryshme mund t'i bëhen kësaj Kontrate vetëm me shkrim dhe duhet të nënshkruhen nga Palët.

Neni 10

Anekset e kontrates

Kesaj kontrate i bashkengjiten si pjese perberese dhe te pandara keto dokumenta qe do te quhen Anekse te kontrates. **Pjesë përbërëse të kësaj kontrate është dhe dokumentacioni bashkangjitur:**

Ekstrakti i Regjistrimit Tregetar

Kopje te leternjoftimeve te personave nenshkrues

Vendimi i Asamblese se Pergjithshme.

Neni 11

Dispozitat Përfundimtare

Kontrata e Shitjes pasuri e luajtshme - *Kuota te kapitalit*, u lexua nga unë Noteri me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të *Palëve*, të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noterit.

Kontrata u hartua në gjuhën shqipe prej meje Noterit në 4 (katër) kopje, me vlera të njëjta juridike; mbështetur në shprehjen e lirë e të plotë të vullnetit të palëve kontraktuese.

Njëra kopje vendoset në arshivën noteriale, një kopje i dërgohet QKB-se përkatëse për regjistrim per te kryer veprimet e nevojshme prane QKB-se dhe nga një kopje u vihet në dispozicion respektivisht palëve kontraktuese.



A2022052940175068486

Unë Noteri, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”, vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

PALËT KONTRAKTUESE

SHITES

Shkelqim Beshiri

Shkelqim Beshiri

BLERES

Enkelejda Beshiri

Enkelejda Beshiri

Noter

ANILA Q. KAÇUPI

